

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

E.Rev.nr.15/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar, Rrustem Thaqi dhe Milena Gjeriq, anëtarë, në kontestin e paditësit "N.P.H "R.", me seli në M., të cilën me autorizim e e përfaqëson Faik Halili, avokat nga P., kundër të paditurës K. K. për D. dhe F. me E. E.(KEDS) sh.a, me seli në P., të cilën sipas autorizimit e përfaqësojnë L. S. dhe A. K., për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale- Dhomës së Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr.867/2022, datë 02.06.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 29.04.20292024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pa bazuar revizioni i paditësit "N.P.H "R." me seli në M., kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale- Dhomës së Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II nr.867/2022,datë 02.06.2023.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Deparamenti për Çështje Ekonomike, V.EK.nr 118/2018, datë 28.07.2021, "Refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses N.P.H "R." me seli në M.ë, e paraqitur kundër të paditurës K. K. për D. dhe F. me E. E. (KEDS) sh.a, me seli në P., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura, që në emër të kompensimit të dëmit material, paditëses t'ia kompensojë shumën prej 149,705.50 €, me kamatë në shkallën prej 8 % në vit, duke llogaritur nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. II. Ddetyrohet pala paditëse që të paditurës në emër tëshpenzimeve të procedurës kontestimore te paguajë shumën e mjeteve në lartësi prej 900€".

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale- Dhomës së Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II nr.867/2022, datë 02.06.2023, është refuzuar, si e pabazuar, ankesa e paditësit "N.P.H "R." me seli në M., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, V.EK.nr. 118/2018, të datës 28.07.2021, vërtetohet.

Kundër aktgjykimit të lartpërmendur të gjykatës të shkallës së dytë, paditësi, përmes të autorizuarit, avokat Faik Halili nga P., me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të anulohen të dy aktgjykimet e sipërpërmendura dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në revizionin e të paditurës, nuk ka paraqitur pala paditëse.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurë Kontestimore (LPK) dhe sipas pretendimeve të revizionit shqyrtoi aktgjykimin e goditur, revizionin e paditësit si dhe shkresat e lëndës dhe gjeti se:

Revizioni i paditësit është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi ka parashtruar në gjykatë padi, kundër të paditurës K. K. për D. dhe F. me E. E. (KEDS) sh.a, me seli në P., për shkak të kompensim të dëmit, duke theksuar se më datë 23.11.2015, rreth orës 01:30 pas mesnatës, në kompleksin e objekteve afariste të palës paditëse, ka shpërthyer zjarri, e ku sipas raportit preliminar, është konstatuar se shkak i shpërthimit të zjarrit ka ndodhur për shkak të energjisë elektrike dhe për këtë ka kontribuar mosfurnizimi i rregullt i energjisë elektrike, tensioni jostabil, e për pasojë ka ardhur deri te shkaktimi i harkut elektrik, i cili ka krijuar temperaturë të lartë dhe shpërthim të flakës, ku fillimisht është shkaktuar zjarri i madh duke filluar nga siguresat e trafos të cilat nuk kanë qenë adekuate deri në brendi të lokalit, ku në vend të siguresave kanë qenë të vendosura disa tela përçues nga ana e të paditurës edhe pse "telat përçues" janë të ndaluar me ligj për t'i vendosur. Pala paditëse më tej thekson se pas ndodhjes së kësaj ngjarjeje, si pasojë e së cilës i është shkaktuar dëm paditëses, e njëjta ka njoftuar gjykatën kompetente, e cila ka bërë sigurimin e provës. Andaj i ka propozuar gjykatës që të detyrohet e paditura që në emër të kompensimit të dëmit material, paditëses t'ia kompensojë shumën prej 149,705.50€, me kamatë në shkallën prej 8 % në vit, duke llogaritur nga data e parashtrimit të padisë, e deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

E paditura e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit duke deklaruar se furnizimi me rrymë ka qenë i rregullte dhe në përputhje me normat, dhe se shkaktimi i zjarrit ka ndodhur në zonën e përgjegjësisë së të paditësit, për shkak të mbingarkesës së kabllos vazhduese, ku në një prizmeë janë vendosur shumë shpenzues.

Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe vlerësimit të provave të lëndës, ka konstatuar se padia dhe kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar. Fillimisht ekspert i individual ka dhënë mendimin e tij më datën 27.01.2016, por se me kërkesën e palës është angazhuar grupi i ekspertëve nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe se në esencë këto dy ekspertiza nuk janë kundërthënëse. Gjykata pas pas vlerësimit të provave dhe në bazë të mendimit dhe konstatimit të dhënë nga ana e grupit të ekspertëve, profesorëve përkatës, të cilës provë gjykata ja fali besimin në tërësi, gjykata vërtetoi se zjarri i ndodhur në objektin e palës paditëse nuk është shkaktuar nga cilësia e energjisë elektrike të furnizuar nga pala e paditur KEDS, dhe as si pasojë e defekteve apo lëshimeve eventuale në rrjetin furnizues të palës së paditur e poashtu vlerat e tensionit kanë qenë në përputhje me standardet. Grupi i ekspertëve ka konstatuar se djegia e shkaktuar nga flaka e jashtme, që ka kapluar motorët prapa banakut e që mund të jetë shkaktuar për faktin se të gjithë stabilimentet elektrikë të palës paditëse, janë furnizuar nga një prizë e vetme, dhe kablli vazhdues i kyçur ka dëmtuar izolimin e qarqeve elektrike të kyçura në momentin para shpërthimit të zjarrit. Për këtë arsye gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, si gjykate e shkallës së dytë, sipas ankesë së të paditurës, e pranon vlerësimin juridik dhe faktik të gjykatës të shkallës së parë, si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore e as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK. Sipas vlerësimit të këtij kolegji dispozitiv i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, rrjedhimisht edhe i pambarueshëm, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitiv i me arsyetimin. Sipas gjykatës së shkallës së dytë, gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendosë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Edhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ku mbi bazën e kësaj gjendje, në mënyrë të saktë është aplikuar e drejta materiale, kur është refuzuar kërkesëpadija e paditësit. Gjykata e

shkallës së dytë, vlerëson se për të ekzistuar dëmi është e nevojshme që të vërtetohet përgjegjësia e shkaktuesit të dëmit e që në rastin konkret nuk është vërtetuar përgjegjësia e paditurit KEDS, qoftë sipas bazës juridike të përgjegjësisë se personit juridik për të shkaktuar demin nga organi i tij apo ndonjë bazë tjetër juridike. Andaj gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Pretendimet palës paditëse për gjendjen faktike të vërtetuar në mënyrë jo të plotë dhe të drejtë, sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë, nuk qëndrojnë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese të cekura si në arsyetim të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Sipas vlerësimit të kësaj gjykatë, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, është i drejtë dhe i argumentuar. Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar, gjykata ankimore e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë për zbatimin e rregullt dhe të drejtë të dispozitave materialo - juridike në të cilat është thirrur me rastin e vendosjes, nga edhe ka rrjedhur se kërkesëpadia e paditësit në rastin konkret është e pabazuar. Gjykata e Apelit e pranon qëndrimet juridike të gjykatës së shkallës së parë të dhëna në aktgjykimin e takuar se në baze të nenit 136.1 të LMD-së, është përcaktuar se kush i shkakton dëm tjetrit, ka për detyrë kompensoi atë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. Në bazë nenit 154 par.1, të Ligjit mbi Detyrimet (kapitulli: bazat e përgjegjësisë) sipas të cilit "kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari, përveç nëse provohet se ato nuk kanë qenë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij". Në kuptim të dispozitës së lartcekur, gjykata kushtet si në vijim: të shkaktohet dëmi (veprimi dëmtues), të ekzistojë veprimi i kundërligjshëm, të ekzistojë lidhja kauzale në mes të shkakut dhe pasojës, si dhe të ekzistojë gjen se për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e demit sipas fajit, duhet të plotësohen faji.

Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës e pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, sipas të cilit kërkesëpadia e paditësit është epa bazuar, pasi që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe ai i gjykatës së shkallës së dytë nuk janë përfshiri me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n, të LPK. Po ashtu aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk përfshihet me shkelje thelbësore procedurale nga neni 204 të LPK, dhe në një gjendje të tillë faktike, e drejta materiale rezulton që është zbatuar drejtë.

Pretendimet për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të themelta. Kjo për shkak se gjykatat e instancave më të ulëta i janë përmbajtur në tërësi kërkesave të LPK-së, për strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimit. Në aktgjykimin e shkallës së parë dispozitivi është i rregullt dhe në përputhje të plotë me arsyetimin e dhënë, ndërsa aktgjykimi i shkallës së dytë përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë, përfshirë edhe shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse lidhur me mënyrën e vendosjes meritore të çështjes kontestuese. Në këtë kontekst, janë dhënë arsye bindëse me të cilat janë treguar faktet thelbësore të cilat janë marrë në vlerësim me rastin e vendosjes meritore, janë dhënë arsye për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e shfrytëzuara dhe për mënyrën e vlerësimit të provave të shfrytëzuara. Në logjikën e njëjtë është edhe aktgjykimi i shkallës së dytë në të cilin paraqiten arsyet për konfirmimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë ka përmbajtje koherente në rrjedhë logjike dhe juridike duke i arsyetuar të gjitha pretendimet ankimore dhe shkeljet që vlerësohen sipas detyrës zyrtare, lidhur me vlerësimin se aktgjykimi i shkallës së parë është i ligjshëm. Në këtë kontekst me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë janë konsumuar të gjitha pretendimet ankimore përmes vlerësimit objektiv dhe në përputhje me dispozita ligjore, prandaj Gjykata Supreme e Kosovës e vlerëson të paqëndrueshëm pretendimin për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore lidhur me strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimeve të instancave më të ulëta.

Ndërsa sa i përket pretendimit se gabimisht është zbatuar e drejta materiale, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësonse ishte vërtetuar, pa dyshim, përmes ekspertizës dhe të gjeturave të ekspertëve të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike, të datës 06.04.2021, dhe në sqarimet shtesë, në seancën e datës 27.05.2021 si dhe në seancën e datës 22.06.2021, në të cilat është konstatuar se zjarri i shkaktuar në objektin palës paditëse nuk është shkaktuar nga furnizimi me energji elektrike nga e paditura, duke theksuar se furnizimi me energji elektrike nga ana e të paditurës, ka qenë në suazat e parapara më Kodin e Shpërndarjes, në kufijtë e përgjegjësisë, ku edhe regjistrimi automatik i vlerave të tensionit në pajisjen e quajtur AMR, dëshmojnë stabilitet të plotë të tensioneve furnizuese të KEDS, e ku janë të përfshira të dhënat një ditë para dhe një ditë pas ngjarjes kritike, dhe vërtetoi se zjarri i ndodhur në objektin e palës paditëse nuk është shkaktuar nga cilësia e energjisë elektrike të furnizuar nga pala e paditur KEDS dhe as si pasojë e defekteve apo lëshimeve eventuale në rrjetin furnizues të palës së paditur e po

ashtu vlerat e tensionit kanë qenë në përputhje me standardet. Grupi i ekspertëve gjithashtu konstaton se një nga faktorët që ka shkaktuar zjarrin mund të jetë fakti se të gjithë stabilimentet hargjuese të ndodhura në lokalit ku ka shpërthyer zjarri, janë furnizuar nga një prizë e vetme dhe kablli vazhdues i kyçur e ka dëmtuar izolimin e qarqeve elektrike të kyçura në momentin para shpërthimit të zjarrit, për shkak të kontakteve dhe izolimeve të dëmtuara është shkaktuar hark elektrik që ka shkaktuar zjarrin. Gjykata Supreme e aprovon qëndrimin e gjykatave të instancave më të ulta për faktin se gjykata e shkallës së parë i ka falur besimin konstatimit të grupit të ekspertëve dhe i ka dhënë mundësi paditësi që të nxjerr provën përmes ekspertizës, mirëpo ekspertet kanë konstatuar se zjarri i shkaktuar në objektin e palës paditëse nuk është shkaktuar nga cilësia e energjisë elektrike të furnizuar nga pala e paditur. Gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditues as për këtë bazë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuar përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike.

Me faktin se shpërndarja e energjisë tek hargjuesit është bërë vetëm me një kabllo dhe gaaty sipas ekspertizës ka buruar edhe zjarri, në kuptim të nenit 155 të Ligjit mbi detyrimet e paditura nuk përgjegjësi për dëmin e shkaktuar dhe rrjedhimisht as për kompensimin e dëmit.

Pala paditëse në revizion pretendon se njëri nga anëtarët e grupit të eksperteve ka konflikt interesi sepse ka punuar më parë në KOST, dhe këto dy kompani kanë ngjashmëri. Ky pretendim dhe pretendimet që kanë të bëjnë me përbërjen e anëtarëve të grupit u refuzan për faktin se në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 22.06.2021, këta ekspert kanë marrë pjesë dhe kanë adresuar të gjitha pyetjet dhe shqetësimet e palëve. Përfaqësuesi i palës që tani e konteston përbërjen e grupit të eksperteve, në seancë nga vetë eksperti ka marrë sqarimet se KEK, KEDS dhe KOST janë ndërmarrje të pavarura. Pala pasditëse ngre dyshime në aftësitë profesionale të eksperteve por nuk e përcakton se cili nga konstatimet e tyre është i pa sakt dhe mbi cilën bazë ekspertiza është jo profesionale. Për këtë arsye nuk qëndron ky pretendim dhe rrjedhimisht pretendimi i tillë është i pa bazuar. Ndërsa sa i përket pretendimit të revizionit se e paditura nuk i ka mirëmbajtur pajisjet, dhe kjo ka shkaktuar ndezjen e kabllit, nuk mund të aprovohet ky pretendim për faktin se mirëmbajtja e rrjetit brenda lokalit bie në përgjegjësinë e paditësit, kurse ekspertiza ka konstatuar pa mëdyshje se zjarri është shkaktuar nga kablli vazhdues në zonën e banakut, brenda lokalit. Prandaj edhe ky pretendim u refuzua si i pa bazuar.

Në revizion përsëriten thëniet e parashtruara në ankesë përkitazi me vlerësimin e fakteve të cilat gjykatat e instancës më të ulët i kanë vlerësuar dhe për të gjitha këto kanë dhënë arsye në

arsyetimin e aktgjytimeve të tyre, ku përsëriten thëniet sa i përket gjendjes faktike. Pretendimet e tilla kjo gjykatë i vlerëson sipas nenit 214.2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, ku parashihet se revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike për derisa revizioni në të vërtetë për këtë arsye i godet aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët. Prandaj, në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike në procedurën e shkallës së parë, gjykatat e instancës më të ulët drejtë kanë zbatuar edhe të drejtën materiale për çfarë arsye pretendimet në revizion paraqiten si të pabazuara.

Për arsyet e paraqitura më lart, revizioni i paditësit, u refuzua si i pabazuar, andaj me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

E.Rev.nr.15/2024, më 29.04.2024

Kryetari i kolegjit,

Beshir Islami